



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sektori i Planifikimit Strategjik

Nr. 985 Prot.

Tiranë, më 26.03.2026

Plani i punës për vitin 2026,
Sektori i Planifikimit Strategjik (ERE)

Sektori i Planifikimit Strategjik (*më poshtë "Sektori"*), në përputhje me misionin e tij për mbështetjen e drejtimit të institucionit në përcaktimin e objektivave afatmesme dhe afatgjata, si dhe në koordinimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike, në përputhje me kuadrin ligjor, politikat dhe prioritetet sektoriale, në përputhje me objektivin kryesor të Strategjisë Kombëtare të Energjisë si dhe ristrukturimin e sektorit të energjisë, bazuar në parimet e ekonomisë së tregut si dhe në zhvillimin e një politike bashkëkohore energjitike, gjatë vitit 2026 planifikon të realizojë këto detyra:

- Rritjen e sigurisë dhe besueshmerisë së furnizimit me energji;
- Krijimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një kuadri efektiv institucional dhe rregullator;
- Krijimin e kushteve të nevojshme për optimizimin e sistemit të furnizimit me burime energjitike, duke u mbështetur në konceptin e planifikimit me kosto sa më të ulët dhe ndikim minimal në mjedis (dekarbonizimi);
- Përmirësimin e kuadrit rregullator për rritjen e ndjeshme të investimeve në sektorin e energjisë nëpërmjet tërheqjes së kapitalit nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare si dhe të kapitalit privat;
- Krijimin e një ambienti sa më të përshtatshëm rregullator për zhvillimin e vazhdueshëm të një tregu energjie konkurrues bazuar në kërkesat e Bashkimit Europian për reformimin e sektorit të energjisë;
- Përpjekjet për përmirësimin e vazhdueshëm të një kuadri ligjor dhe financiar që do të mund t'u përgjigjet nevojave të zhvillimit të tregut të energjisë, për të siguruar funksionimin e një sistemi energjitik sa më efektiv;
- Plotësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe rregullator, sidomos në lidhje me bazën ligjore për politikat energjitike;
- Përgatitja dhe analizimi i informacionit ditor lidhur me gjetjet e raportimit mbi gjëndjen e sistemit elektroenergjitik Shqiptar (SEE);
- Grumbullimi, përpunimi, verifikimi, kuadrimi si dhe analizimi i të dhënave progresive të raportuara nga pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike për vitin 2026;
- Analizimi i të dhënave të tregut të energjisë elektrike për vitin 2026;

- Referimi i shembujve dhe praktikave më të mira në lidhje me zbatimin e rregullores REMIT;
- Analiza dhe mbikëqyrja e të dhënave të subjekteve të regjistruara në REMIT (platforma e dedikuar për këtë regjistër);
- Përditësimi i të dhënave dhe raportimeve periodike dhe progresive për vitin 2026;
- Përvetësimi dhe ndjekja e praktikave më të mira të industrisë (rregullatorët në rajon dhe më gjerë si dhe ato të rekomanduara nga Sekretariati i Energjisë) që kanë të bëjnë specifikisht me Sektorin;
- Ndjekja e trajnimeve apo literaturës dhe materialeve që kanë të bëjnë kryesisht me nevojat e Sektorit;
- Ndjekja e të gjitha korrespondencave për trajtim pranë Sektorit (në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera) si dhe zbatimi i të gjitha detyrave të ngarkuara për ndjekje (rast pas rasti);
- Konsultimet brenda sektorit, drejtorive apo dhe strukturave të tjera në ERE për organizimin dhe ndarjen e punës;
- Përgatitja e praktikave dhe ndjekja e seancave dëgjimore të organizuara nga ERE për çështjet që i takojnë Sektorit;
- Ndjekja e problematikave sipas grupeve të punës të ngritura në përputhje me kopetencat rregullatore të ERE;
- Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave apo informacioneve të nevojshme të mundësuar nga pjesmarrësit e tregut në sektorin e energjisë elektrike;
- Shqyrtimi dhe miratimi i praktikave të ndryshme sipas problematikave specifike që ato prezantojnë;
- Vlerësimi i raporteve periodike mbi sigurinë kibernetike që dorëzohen nga operatorët përgjegjës në këtë drejtim;
- Komunikimi i vazhdueshëm me operatorët dhe pjesëmarrësit e tregut të energjisë;
- Vlerësimi i planeve të investimeve të operatorëve në lidhje me masat dhe procedurat e vendosura për minimizimin e risqeve në fushën e sigurisë kibernetike në sektorin e energjisë elektrike si dhe sistemimi në vazhdimësi i dokumentacionit të shkëmbyer për këtë qëllim me secilin prej tyre;
- Përditësimi i akteve si dhe, në rast nevojë, dhënia e propozimeve përkatëse për ndryshim;
- Njohja me shkallën e respektimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi nga pjesmarrësit e tregut;
- Njohja me zbatimin e detyrimit të transparencës nga pjesmarrësit e tregut;
- Njohja me ecurinë e operimit të Bursës (ALPEX);
- Njohja me respektimin nga pjesmarrësit e tregut të kërkesave të kodeve, rregullave apo akteve të tjera specifike të miratuara nga ERE;
- Njohja me dokumentacionin dhe korrespondencën e shkëmbyer me pjesmarrësit e tregut në lidhje me operimin e tyre në treg si dhe respektimin nga ana e tyre të marrëveshjeve të rregulluara, të miratuara nga ERE;
- Evidentimi i detyrimeve të pjesmarrësve të tregut në funksion të operimit të tyre në treg në përputhje me aktet rregullative në fuqi;
- Përpunimi dhe analizimi i treguesve tekniko-ekonomikë sipas evidencave periodike ose dokumentave të tjera raportuese si dhe sigurimi, ruajtja dhe sistemimi i dokumentacionit të



shkëmbyer me pjesmarrësit e tregut me qëllim shfrytëzimin sa më eficient të këtij dokumentacioni;

- Përpilimin e raporteve dhe të dhënave për strukturat e ERE-s dhe më gjërë;
- Përgatitja e raportit vjetor të ERE-s për vitin 2026, për sa i takon Sektorit;
- Pjesëmarrja në mbledhjet e Bordit për vitin 2026;

Enton Shahaj

Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit Strategjik (ERE)

